



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:078240
Datë: 15.05.2024
Numri i dokumentit: 05684902

2023:147837

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësit H.B. nga fshati ..., Komuna Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. Islam Musa nga Ferizaj, kundër të paditurit A.B. nga fshati ..., Komuna Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. Miftar Islami nga Ferizaj, me objekt kontesti vërtetim pronësie, me vlerë të kontestit 20,000€, pas mbajtjes së seancës së datës 14.05.2024 në prezencë të përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse dhe të paditurit, më datën 15.05.2024, jashtë seancës mori këtë:

AKTVENDIM

- I. Ftohet paditësi H.B. nga fshati ..., Komuna Ferizaj, që si palë të paditur në procedurë në padi të përfshijë të gjithë bashkëpronarët të paluajtshmërive kontestuese, edhe atë Xh.B. nga fshati ..., Komuna Ferizaj, me numër personal Nëse ndonjëri prej tyre ka vdekur në vend të tyre të paraqiten trashëgimtarët e tyre.
- II. Nëse paditësi nuk vepron ashtu siç është udhëzuar nga gjykata në pikën I. të dispozitivit të këtij aktvendimi, në afatin prej 3 (tri) dite, gjykata do hedhë poshtë padinë e paditësit.

Arsyetim

Paditësi H.B. nga fshati ..., Komuna Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. Islam Musa nga Ferizaj, ka ushtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurit A.B. nga fshati ..., Komuna Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. Miftar Islami nga Ferizaj, me objekt kontesti vërtetim pronësie.

Ftohet paditësi që të bëjë përmirësimin e padisë, ashtu që në padi përveç të paditurit A.B. nga fshati ..., Komuna Ferizaj, të përfshijë edhe të gjithë bashkëpronarët e tjerë të paluajtshmërive

objekt kontesti (me numra kadastral ..-0, ..-0, ..-0 dhe ...-0 ZK ...). Në të kundërtën padia do të hudhet poshtë.

Baza ligjore qëndron në nenet 269, 78.1 dhe 78.4 të LPK.

Ndërsa aktvendimi i gjykatës mbështetet në provat shkresore të cilat gjinden në shkresat e lëndës përkatësisht në ekspertizën gjeodezike të ekspertit gjeodet Z.E. nga Ferizaj, përkatësisht certifikatës së bashkëngjitur të njësisë kadastrale numër P-...-0 të dt. 29.05.2019 ZK ..., numër ...-0 të dt. 29.05.2019 ZK ..., numër ...-0 të dt. 29.05.2019 ZK ..., numër ...-0 të dt. 29.05.2019 ZK ..., ku bashkëpronarë të këtyre parcelave figurojnë Xh.B. me 1/5 pjesë ideale, A.B. me 3/5 pjesë ideale (këtu i padituri) dhe H.B. me 1/5 pjesë ideale (këtu paditësi).

Sipas nenit 51 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore i Republikës së Kosovës parashihet se: “1. Në qoftë se pronësia në një send u takon disa personave në pjesë të caktuara (alikuote) ata kanë bashkëpronësi në send. 2. Në qoftë se pjesët e bashkëpronarëve janë të pacaktuara, atëherë prezumohet se ato janë të barabarta”. Sipas nenit 53.1 të këtij ligji thuhet se: “1. Bashkëpronarët e administrojnë së bashku një send, në të cilin ekziston bashkëpronësia.”

Kurse sipas nenit 54 të LPDTS parashihet decidivisht se: “Secili bashkëpronar mund të parashtrorë kërkesat kundrejt personave të tretë lidhur me tërë sendin, kërkesa për kthim dhe për prestimet që sipas natyrës së tyre janë të pandashme mund të parashtrohen nga bashkëpronari vetëm në atë mënyrë, që prestimi të bëhet ndaj të gjithë bashkëpronarëve.”

Poashtu sipas nenit 264, par. 1, pika a), b) dhe c) e LPK parashihet se: “264.1 Padia mund të ngrihet bashkërisht nga shumë paditës ose kundër shume të pa diturve (bashkëndërgjyqësia) në rast se: a) në pikëpamje të objektit të kontestit janë në bashkësi juridike apo nëse të drejtat e tyre, përkatësisht detyrimet, burojnë nga e njëjta bazë faktike apo juridike (bashkëndërgjyqësia materiale) b) objekt kontesti janë kërkesat, përkatësisht detyrimet e të njëjtit lloj që mbështeten në bazën faktike dhe juridike esencialisht të njëjtë dhe po që se ekziston kompetenca lëndore dhe territoriale e të njëjtës gjykatë për secilën kërkesë dhe për secilin të paditur (bashkëndërgjyqësia formale); c) një gjë e këtillë parashikohet me ndonjë ligj tjetër.” Bashkëndërgjyqësia e domosdoshme, këtë lloj të bashkëndërgjyqësisë e determinojnë rregullat materialo - juridike, e jo proceduralo - juridike. Bashkëndërgjyqësia është e domosdoshme vetëm në rastet kur paditësi me padi duhet detyrimisht ta formoj bashkëndërgjyqësine pasive, duke përfshirë në të të gjitha

subjektet që janë pjesëmarrës të marrëdhënies juridike civile, si në këtë rast bashkëpronarët si bashëndërgjyqës unik.

Nga të gjitha të lartcekurat, e konform nenit 142 të LPK u vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Themelore në Ferizaj

Datë 15.05.2024

Gjyqtari Armend Ahmeti

Këshilla juridike: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa e veçantë, konform nenit 78.5 të LPK.